Kronikë

Vrasja e policit në Fier, autori ende në arrati! Dyshohet se fshihet në Apoloni, po kërkohet në bunkerë! Negociata me familjarët për t'u dorëzuar

Autori i vrasjes së efektivit të Shqiponjave në Fier është ende në arrati. Policia ende nuk ka rënë në gjurmën e Azgan Mërnicës, i cili qëlloi me plumb në kokë policin pas një konflikti për përparësinë e lëvizjes me makinë. 23-vjeçari dyshohet se fshihet në Apoloni, ***30 mijë euro shpërblim për çdo informacion që çon në kapjen e tij.***

- Vrasësi i policit në Fier pjesë e Strukturës së Armatosur të PD për Mbrojtjen e Votës në 2021 (FOTO)
- E shkuara kriminale e familjes/ Babai i autorit kreu 20 vite burg! 2 vëllezër në qeli
- Dëshmia e nënës së autorit: U zunë për kalimin në rrugë
- Vrau policin pas sherrit se kush kalon i pari në rrugë, autori ishte në makinë me mamanë
- Polici përcillet nesër për në banesën e fundit! Homazhe në teatrin e Bylisit në Fier
- RENEA 'blindon' Fierin, kontrolle për kapjen e autorit të vrasjes së policit

Redaksia
14 Maj, 08:15 | **Përditesimi: 14 Maj, 16:30**

Share

FIER- Azgan Mërnica, autori vrasjes së policit në Fier prej 24 orësh është në arrati. 23-vjeçari ka lëvizur në këmbë nga fshati i tij, Sulaj në Havaleas dhe Apoloni. Forca të shumta të policisë së Fierit, FNSH-së dhe RENEA janë angazhuar në kërkime dhe aktualisht janë përqendruar në afërsi të parkut të Apollonisë, ku dyshohet se autori qëndron i fshehur në ndonjë bunker.

Po kështu po ushtrohen kontrolle në automjete përgjatë aksit Fier-Seman. Ka negociata me familjarët për t'u vetëdorëzuar, babai deri tani ka qenë bashkëpunues me policinë, por nuk ka rezultate akoma.

23-vjeçari ekzekutoi mesditën e së hënës me plumb në kokë, efektivin e Shqiponjave Novruz Canaliaj, i cili përcillet nesër në banesën e fundit. Shkak për vrasjen dyshohet se është bërë nje konflikt i momentit për kalimin e një rruge të ngushtë në fshatin Baltëz, ku jetonte viktima, ndërsa autori jetonte në fshatin fqinj.

LEXO EDHE:
Luan Baçi: Nuk jam pishman për foton me vrasësin e policit në Fier! Janë fis i nderuar! Gënjen kush thotë se ka qenë te protestat para bashkisë Tiranë

Mësohet se Azgan Mernica, shoqërohej nga nëna e tij në makinë, kur ndodhi krimi. Ajete Mërnica në dëshminë e dhënë për hetuesit është shprehur se gjithçka ka ndodhur shumë shpejt. I biri zbriti nga makina dhe nisi të konfliktohej me policin.

> *"Kam dëgjuar një të shtënë arme", ka deklaruar nëna e autorit, "më pas djali më ka dërguar me makinë te shtëpia e vëllait tim dhe është larguar".*

Mërnica, i cili ka dhe vëllanë në burg per tentative vrasje ka qenë i angazhuar në ***Strukturën e Armatosur të PD*** për Mbrojtjen e Votës në 2021. Kjo faktohet lehtësisht përmes një fotoje të postuar nga deputeti i Berishes, Luan Baci në prill të vitit 2021.

Si u vra efektivi i 'Shqiponjave?

28-vjeçari Novruz Cenalia u vra me një ***plumb në kokë*** më 13 maj 2024 në fshatin Baltëz të Fierit. Ai ishte nisur për të shkuar në punë, por u përfshi në një debat me Azgan Mërnicën, 23 vjeç, për radhën e kalimit me makinë. Në këtë moment, 23-vjeçari nxori pistoletën që e mbante me vete dhe me një tek plumb në kokë la të vdekur në vend punonjësin e Policisë së Shtetit. Më pas ai u largua nga vendi i ngjarjes.

Rendit zhvillimet sipas orarit: Të Fundit

Ora 14:23

RAPORTO! Chat live me Shqiptarja.com

E shkuara kriminale e familjes së vrasësit të policit në Fier! Babai u dënua me 20 vite për vrasjen e kunatit, 2 vëllezërit e tij ende në burg

Autori Azgan Mërnica dhe polici i vrarë Novruz Canalia

RENEA dhe Policia e Fierit po vijojnë me kërkimet për kapjen e autorit të vrasjes së policit në Fier. Dyshimet janë se ai është fshehur në Apoloni dhe se nuk ka dalë nga Fieri. Kështu kontrollet janë përqendruar në këtë zonë, ndërsa po ushtrohen kontrolle edhe nëpër banesa.

Armën e krimit në momentin e largimit nga vendi i ngjarjes 23-vjeçari Azgan Mërnica e ka marrë me vete dhe dyshohet se është i armatosur.

Report Tv mëson edhe detaje nga e shkuara kriminale e familjes së autorit. Babai i tij, Petrit Mërnica ka bërë 20 vite burg për vrasjen e kunatit.

Ndërkohë, një prej vëllezërve është në burg për tentativë vrasje. Vëllai Kiri Mërnica bashkë me 3 të tjerë më 17 prill 2021 u përfshi në një konflikt ku mbeti i plagosur Pashk Palnikaj.

Po ashtu, Kiri Mërnica akuzohet si i përfshirë në një ngjarje të ndodhur në 2019-ën, ku u vra me armë zjarri Florian Selimi, me origjinë nga Tropoja dhe banues në fshatin Sulaj. I riu, Novruz Cenalia sipas burimeve nga mediat, kishte vetëm një muaj që ishte martuar, ndërsa sot ndërroi jetë.

Ndërkohë edhe vëllai tjetër i 23-vjeçarit është i në burg në Gjermani.

SI.E./Shqiptarja.com

Share

Ora 11:16

Vrasja e policit në Fier, dëshmia e nënës së autorit: U zunë për kalimin në rrugë, dolën nga makina dhe debatuan! U thash mos, por djali e qëlloi

Në makinë me Azgan Mërnica gjatë konfliktit me policin 28-vjeçar ishte edhe nëna e autorit. Ajo ka dhënë deklarime në polici dhe para grupit hetimor ka rrëfyer sherrin që djali i saj kishte me Novruz Cenalinë. Nëna e autorit, Ajete Mërnica, i tha policisë se dy të rinjtë u konfliktuan për kalimin në rrugën e ngushtë të fshatit.

Më pas, sipas saj, ata dolën nga makinat dhe debatuan me fjalë. Në këto momente gruaja deklaroi se u tha te rinjve "mos, mos" disa herë por djali i saj me pas e qëlloi me pistoletë policin 28-vjeçar.

Grupi hetimor ka përjashtuar dy prej pistave që u ngritën në fillim që vrasja mund të jetë si hakmarrje për ngjarjen e ndodhur në vitin 2005 në Has por edhe pistën tjetër që mund të jetë hakmarrje për arrestimin e vëllait të autorit nga babai u viktimës lidhur me vrasjen e Florian Selimit në vitin 2019.

SI.E./Shqiptarja.com

Share

Ora 10:31

RENEA 'blindon' Fierin, kontrolle gjatë gjithë natës për autorin e vrasjes së policit në Sulaj, Havaleas, Apolloni

RENEA dhe forcat Shqiponja' po vijojnë kontrollet në Fier për kapjen e autorit të vrasjes së policit Novruz Cenalia.

23-vjeçari Azgan Mërnica është end enë kërkim, ndërsa kontrollet janë përqendruar në fshatin Sulaj dhe Havaleas, ku dyshohet se është larguar autori i vrasjes.

Pasi braktisi makinën në fshatin Baltëz, autori është larguar në drejtim të këtyre dy fshatrave dhe më pas në Apoloni në këmbë.

Policia ka kontrolluar përgjatë gjithë natës në zonën Sulaj, Havaleas, Apolloni. Deri më tani janë shoqëruar 12 persona, familjarë të autorit.

SI.E./Shqiptarja.com

Share

Ora 10:19

Vrasja e policit, nesër përcillet për në banesën e fundit! Homazhe në teatrin e Bylisit në Fier

Polici i Fierit Novruz Cenalia i cili u vra një ditë më parë do të përcillet nesër për në banesën e fundit.

Para ceremonisë mortore, në teatrin e Bylistit do të mbahen homazhe në nder të policit që u vra me një plumb në kokë teksa po shkonte të merrte detyrën.

SI.E./Shqiptarja.com

Share

Ora 09:47

Vrasja e policit në Fier, Policia kontrolle makinave në aksin Fier-Seman

Policia vijon kontrollet për kapjen e autrit të vrasjes sëpolicit Nevruz Cenalia në Fier. Report Tv sjell pamje ndërsa efektivët ushtrojnë kontrolle në rrugën kryesore Fier-Seman.

Policia ushtron kontrolle brenda mjeteve.

Deri më tani nuk ka asnjë gjurmë nga autori Azgan Mërnica, 23 vjeç.

SI.E./Shqiptarja.com

Share

Ora 09:01

Vrau policin pas sherrit se kush kalon i pari në rrugë, autori ishte në makinë me mamanë

Autori Azgan Mërnica, në kërkim nga policia

Detaje të reja kanë dalë nga vrasja e policit Novruz Cenalia në Fier. Mësohet se autori i vrasjes ka qenë në makinë me mamanë në momentin kur ka qëlluar me një plumb në kokë policin 28-vjeçar.

Gjithçka nisi pas një sherri se kush do kalojë i pari me makinë në rrugën në fshatin Baltëz, kur autori Azgan Mërnica e qëlloi për vdekje efektivin.

SI.E./Shqiptarja.com

Share

SI.E./S.G/Shqiptarja.com

TAG: asllan mernica | Novruz Cenalia | vrasja e policit ne fier

Komento

Komente

titi kavajes: 14/05/2024 16:53

te kapet dhe te varet por edhe te rrihet mire nga policia

Përgjigju

Turi: 14/05/2024 16:11

Shihni statistikat! Ku ka shpedhar ka krim!

Përgjigju

Shpellari: 14/05/2024 18:06

Kerkoni bunkeret e na lini rehat ne shpellareve

Agjenti: 14/05/2024 16:08

Familje kriminelesh. Ju vrafte zoti pjelle e keqe

Përgjigju

Deri: 14/05/2024 15:57

Po kjo qenka familje me parime.

Përgjigju

E. Rama: 14/05/2024 12:30

Kokat hengshin

Përgjigju

Nena: 14/05/2024 11:38

Kjo vetem nene nuk esht derisa ka rrit nje kriminel qe i armatosur i merr jeten nje njeriu.Sot nje tjeter nene varros femijen e saj sepse ky kriminel i mori jeten.Uroj qe policia te tregoj qe shteti nuk preket dhe ta eliminoj nje perbindesh te tille dhe kjo nene perbindesh ta provoj te njejten dhimbje qe i biri i shkaktoi asaj nenes tjeter.

Përgjigju

© Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

SH .COM

Sondazhi i ditës:

Si i vlerësoni mesazhet që dha Rama në takimin me diasporën në Athinë?

Të duhura | Të gabuara | Nuk e di

Lajme të tjera

Komisioni i Sigurisë mban 1 minutë heshtje për policin e vrarë në Fier! Salianji: Autori të marrë ndëshkimin e merituar

14 Maj, 15:01

Vrasja e policit pas sherrit kush do kalojë rrugën, sociologu: Shoqëri e dhunshme, se perceptojmë dot që ligji duhet zbatuar

14 Maj, 14:39

E shkuara kriminale e familjes së vrasësit të policit në Fier! Babai u dënua me 20 vite për vrasjen e kunatit, 2 vëllezërit e tij ende në burg

14 Maj, 14:23



Vrasja e efektivit të 'Shqiponjave' në Fier/ ish-drejtori, Gledis Nano: Të rritet ndërgjegjësimi për sfidat me të cilat përballen forcat policore

14 Maj, 13:58

Vrasësi i policit në Fier krah deputetit të Berishës! Pjesë e Strukturës së Armatosur të PD për Mbrojtjen e Votës në 2021 (FOTO)

14 Maj, 10:39

U vra pas sherrit se kush kalon i pari rrugën, efektivi i "Shqiponjave" në Fier ishte martuar vetëm para një muaji

13 Maj, 18:43

Fier/ Vritet me plumb në kokë polici i 'Shqiponjave'! 28 vjeçari me uniformë po shkonte në punë! Policia 30 mijë € shpërblim për gjetjen e autorit (VIDEO + EMRI)

13 Maj, 13:51

© 2011 - 2024 Shqiptarja.com - Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i kesaj faqeje